



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA  
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA  
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIAJ ARHIVA-ARCHIVE OFFICE

Org. Destin.	01	Nr. Prot.	139
Titulli		Br. Prot.	
Nr. i faqeve	01	Data	22.12.2011
Numri i stranicave		Datum	
No. pages		Date	22.12.2011



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 08/12

Datë: 22.12.2011

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 2, 3, 4, 5 dhe nenit 49 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Urdhërohet operatori i telefonisë mobile d3-mobile të bëjë asgjësimin e të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara me rastin e verifikimit të të dhënave personale.
2. Të asgjësohen dokumentet e abonentëve të cilët nuk janë aktiv dhe të cilët i kanë kryer detyrimet apo pasi t'i ketë përmbyllur procedurat gjyqësore.
3. Asgjësimi i tyre duhet të bëhet deri më 15. 02. 2012
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimit është konstatuar që operatori i telefonisë mobile d3-mobile gjatë regjistrimit të abonentëve depoziton kopje të dokumenteve personale, andaj siç është specifikuar në nenin 3 pika 2, 3, 4, dhe 5 të Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, depozitimi i këtyre të dhënave e ka tejkaluar qëllimin për të cilin përpunohen.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror  
Državni Nadzornik

Mentor Hoxhaj

Bekim Demiri

Aleksandar Spasic

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile d3-mobile
- Arkivit të Agjencisë

